



Posta e Kosovës SH. A.
FILATELIA E POSTËS SË KOSOVËS
RISHPALL KONKURS

për dizajn artistik të motiveve për dy pulla postare të tematikes “ 20 Vjetori i Lavdisë” nga programi i vitit 2018.

Tematika e emisionit: “20 Vjetori i Lavdisë” Familja Jashari

Përshkrimi: **Konkurentet në dizajne konkurruese duhet të prezantojnë qëndresen, luftën dhe sakrificën e të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të rënë me 5/6/7 Mars 1998 në Prekaz, si dhe në veqanti të familjes Jashari. (vizatim, grafikë, fotografi artistike, pikturë).**

Shpërblimi: **Vendi i parë €400; vendi i dytë €300.**

RREGULLAT E KONKURRIMIT:

- Dizajnet artistike të bazuara në këto tema duhet të punohen në programe të specializuara për dizajn (Adobe Photoshop, ilustrator, Corel Draw, apo pamje nga piktura, fotografi, vizatime personale etj, të përpunuara grafikisht); të njëjtat duhet të dorëzohen të shtypura dhe në fajll kompjuterik.
Punimet me rezolucion më të ultë se **500 px**.(TIFF ose PDF) nuk pranohen.
- Emri i autorit të dizajnit nuk duhet të shënohet pranë motivit konkurrues, aty duhet të duket vetëm shifra.
- Dizajnet konkurruese për këtë konkurs duhet të dorëzohen në zarfe të mbyllura.
- Një autor mund të konkurrojë me numër të pacaktuar të punimeve, mirëpo me shifra të ndryshme për secilin emision.
- Punimet e printuara konkurruese me CD vendosen në zarf i cili duhet të përmbaj edhe zarfin e mbyllur me shënime personale të autorit.
- Punimet konkurruese për emisione të ndryshme duhet pakëtuar veçmas, duke e shënuar mbi zarf titullin e emisionit për të cilin konkurroni dhe shifrën.
- Përgjegjësinë mbi të drejtat autoriale e mban autori i dizajnit (konkurruesi).

Për shkak të konfidencialitetit dhe për shkak të objektivitetit, në pjesën e jashtme të zarfeve dhe në CD duhet të shënohet vetëm shifra e zgjedhur nga vet autori (askund në punime nuk duhet të duket emri apo mbiemri i autorit, vetëm shifra).

Komisioni i Pullës Postare, gjatë përzgjedhjes së dizajnëve nuk do të ketë qasje në shënime autoriale, por ka të drejtë të verifikojë mbi origjinalitetin e dizajnëve të përzgjedhur.

PK Sh.A. do të bartë obligimet tatimore.

KONKURSI do të jetë i hapur prej datës: 26.01.2018 deri 02.02.2018

dhe do të jetë i publikuar në web faqen:www.postakosoves.com.

Punimet konkurruese nuk do t’iu kthehen autorëve.

Zgjedhjen e punimeve më të mira konkurruese, duke u bazuar në dizajnin më të mirë dhe ndarjen e shpërblimeve do ta bëjë Komisioni i Pullës Postare.

Punimet duhet dorëzuar, apo dërguar në këtë adresë:

FILATELIA

Për Konkurs-Filateli

Ndërtesa e Postës së Kosovës p.n.

Fushë Kosovë 12000

Republika e Kosovës

Për informata shtesë mund të thirrni në numrin e telefonit: **+381(0)38 246 770**, apo të na drejtoheni në e-mail adresë: filatelia@postakosoves.com, ose në ueb faqen zyrtare www.postakosoves.com.